

Përschendetje, të gjithëve! Z. Shala, Ju falënderoj për ftesën dhe ju përcjell njëkohësisht urimet më të mira në emër të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë të Shqipërisë nga të gjithë kolegët përmbarues nga Shqipëria, për këtë 10-vjetor tuajin.

Krijimi i Odës së Përmbaruesve një dekadë më parë ishte një dite e bukur si për drejtësinë në Republikën e Kosovës, ashtu edhe për ne në Shqipëri, që ju kemi aleat profesional, por edhe shpirtëror, pasi besoj ne kuptohemi, me njeri-tjetrin më mirë se sa na kuptojnë të tjerët - brenda kufijve tanë.

Ky përvjetor e gjen përmbarimin privat të Kosovës në funksionim efektiv.

10 vjet ndoshta nuk janë shumë, por as pak për të kuptuar kontributin tuaj në krijimin e identitetit institucional brenda sistemit të drejtësisë në Kosovë, por dhe për të bërë një bilanc kontributësh brenda tij.

Jam i sigurt se kontributi juaj për ndërtimin e shtetit të së drejtës në Kosovë është i madh, edhe pse i padukshëm, apo shpesh i kontestueshëm.

Por ne dimë që nuk ka drejtësi, nëse ajo nuk ekzekutohet – nëse nuk realizohet, apo mbetet thjesht në letër - ndaj nëse në Kosovë flitet për Drejtësi dhe bëhen lavde dhe vlerësime për evoluimin e saj që nga Shpallja e Pavarësisë, atëherë Oda dhe përmbaruesit e saj janë patjetër kontribues të rëndësishëm në këtë histori suksesi!

Por ne kemi problemet tona, ashtu si gjithë pjesa tjetër e sistemit të drejtësisë apo e shoqërisë shqiptare, sepse ne nuk jemi engjëj. Po flas me Ne, se besoj kemi të njëjtat probleme, të njëjtat pengesa, të njëjtat luftëra dhe, mbi të gjitha të njëjtin mentalitet qeveritar në të dyja anët e kufirit simbolik.

Çështja e tarifimit të punës sonë/shërbimit që japim, mbetet një çështje e debatit konstant ndërmjet Dhomës/Odës dhe ministrive përkatëse, shkurt ndërmjet **nesh - përmbaruesve dhe politikës**. Do ta quaj politikës pasi firmosja e tarifave nga një ministër i qeverisë mbetet thjesht çështje e një politike shtetërore.

Përmbarimi është profesioni ynë, është çështja jonë, por s'mund të jetë domeni ynë!

Ashtu si edhe atributet e ministrave nuk janë **domeni i tyre**, pasi të dyja palët jemi dhe do të duhet të jemi - në shërbim të qytetarëve!

Ndaj le ta kthejmë çështjen tonë, në një çështje të qytetarëve si në Kosovë ashtu dhe në Shqipëri.

Besoj se vitet që vijnë do të jenë të rëndësishme për Odën që ta kthejnë çështjen e përmbarimit në një çështje të vetë qytetarëve, të cilët, **do të jenë ata vetë që do të kërkojnë mbrojtjen e përmbaruesit nga të gjitha tallazet e politikës.**

Ju faleminderit dhe urimet më të mira për këtë 10-vjetor!